



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VII  
Kryesia e Kuvendit

P-032  
Prishtinë, më 5 janar 2021, në orën 15:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 5 JANAR 2021**

**Në mbledhje morën pjesë:** Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Kuvendit; Arbërie Nagavci, Memli Krasniqi dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Ismet Krasniqi dhe stafi përgjegjës për mbështetje Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani-Sadriu.

Kryesia, me propozimin e kryetares, i zhvilloi punimet me këtë:

**Rend dite**

**Kërkesa e kryeministrit të Republikës së Kosovës për mbajtjen e seancës plenare për shqyrtimin e propozim-vendimit të Qeverisë për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.**

Kryetarja i njoftoi të pranishmit me përmbajtjen e dy shkresave, me të cilat kryeministri i Kosovës, z. Avdullah Hoti, i ishte drejtuar Kryesisë Kuvendit. Me shkresën e parë, kryeministri kishte kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që të caktohet një seancë plenare sa më parë, ndërsa me shkresën e dytë, ai kishte propozuar që Kuvendi të mbajë seancë të jashtëzakonshme, më 5 janar 2021, në orën 18:00, me këtë rend dite:

*1. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.*

Kryetarja i njoftoi të pranishmit për procedurat e mbajtjes së seancës së jashtëzakonshme, si dhe për nevojën e shmangies nga afatet procedurale të parapara në nenin 15.7 të Rregullores së Kuvendit për ta shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.

Lidhur me propozim-vendimin e Qeverisë për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit diskutuan nënkryetarët e Kuvendit, Arbërie Nagavci dhe Memli Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartshënuara, Kryesia e Kuvendit njëzëri vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet më 5 janar 2021, me fillim në orën 18:00, në të cilën do të diskutonin vetëm nga një përfaqësues i secilit grup parlamentar, me këtë:

Rend dite

*1. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.*

Kryetarja e mbylli mbledhjen e kryesisë së Kuvendit në orën 15:20 minuta.

*E përgatiti:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*

*P.S.:*

*Ky procesverbal nuk është miratuar për shkak të shpërndarjes së Legjislaturës VII.*